



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

E.nr.1019/13

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje prej gjyqtarit përbarues Isa Gashi, me zyrtarin e përbarimeve Luan Sopa, duke vendosur në lëndën përbarimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a, Prishtinë, ndaj debitorit A. H. S. nga fsh. ... K. ..., për realizimin e kërkesës në të holla në shumë prej 94.27-€ dhe shpenzimet e procedurës përbarimore në shumë prej 15-€, jashtë seancës gjyqësore, me datën 06.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura në këtë çështje përbarimore e kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a. Prishtinë, ndaj debitorit A. H. S. nga fsh. ..., pasi që debitori e ka përmbushur obligimin ndaj kreditorit, në shumë prej 94.27-€, dhe shpenzimet e procedurës përbarimore në shumë prej 15-€.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kësaj gjykate E.nr.1019/13 të datës 23.01.2014, është caktuar përbarimi në dobi të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a. me seli në Prishtinë, ndaj debitorit A. H. S. nga fsh. ..., për realizimin e kërkesës në të holla, në shumë prej 94.27-€, në emër të shpenzimeve të procedurës përbarimore shumë prej 15-€, me ndalimin e mjeteve me para të cilat debitori i ka në llogarinë e tij dhe bartjen e kësaj shume në llogari të kreditorit, me regjistrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit.

Me dispozitat e nenit 66 par 4 të LPP-së, nr. 04/L-139 të datës. 20.12.2012, parashihet se “Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përbarimore”.

Megenëse debitori e ka përmbushur obligimin ndaj kreditorit më dt.06.10.2023, për këtë gjykata konform dispozitave të lartëcekura e përfundoi procedurën përbarimore në këtë çështje..

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN.

E.nr.1019/13 me datën 06.10.2023.

**Gjyqtari
Isa Gashi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës e Apelit të Kosovës në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.